



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 945/13 prot.

Vlorë, më 23.07.2018

VENDIM

Nr. 47, datë 12.07.2018

**PËR
MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE NE SHKENCA INFERMIERORE"**

Mbështetur në pikën 3 në nenin 75, shkronjën dh të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën f të pikës 2 në kreun III të VKM-së nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.07.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit Publik për riorganizim të programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave ne shkenca infermierore" në përshtatje me kërkesat në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".
2. Të miratojë ndryshimet e mëposhtme:
 - a. Tema e diplomës nga 20 kredite të bëhet me 18 kredite për t'iu përshtatur përqindjes (10-15%) që i korrespondon këtij tipi të komponentit mësimor per programet "Master i shkencave".
 - b. Praktika profesionale nga 10 kredite të bëhet me 12 kredite për t'iu përshtatur përqindjes (10%) që i korrespondon këtij tipi të komponentit mësimor per programet "Master i shkencave".
3. Ky program studimi do të zbatohet për vitin akademik 2018-2019.
4. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

